

Kujdes kokën,

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8J4-7

Q 16

Zotërinj!



Poemë satirike

LUAN QAFEZEZI

8J4-7
16

8

LUAN QAFËZEZI

KUJDES KOKËN, ZOTËRINJ!

(poemë satirike)



Tiranë, 1972

Redaktor: MOISI ZALOSH NJA
Piktor: ZEF BUMÇI

Tirazhi 4.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1972

*Armës symprehtë të Sigurimit të Shtetit,
Heronjve të saj të heshtur
me dashuri*

Autori

PJESA E PARË

TAKIM I PËRMALLSHËM

Një nat'vjeshte për së fshehti,
Ende mir'pa dal nëntori,
Midis dallgëve të shumta
Për «kurbet» u nis vapori!

Hej vapor, more vapor,
Ç'po i shpënke matan'detit
Gjithë zotërinjtë e Ballit
«Trimat» e Legalitetit!

E me ta edhe Maklenin,¹⁾
Oficerin me nishan,

1) Makleni, oficer anglez i ndërlihdjes pranë forcave të reaskionit Ball-Legalitet. Ai, në nëntor 1944, u largua nga Shëngjini së bashku me krerët e tradhëtisë, me të njëjtën motobarkë.





Hej Maklen, ta prefsha synë,
Ku m'i çon, mor «babaxhan»?

Por Makleni, jo, nuk ndalet.
Për të ardhmen po u flet,
«Trimave që tundën malet»
«Trimave që shkundën retë».

Shkuan. . . shkuan, po atdhenë,
Obobo se ç'hall e gjeti,
Ja, tani për Shqipërinë
Do të bëhet kiameti!

Se, lum miku, s'shkohet jeta
Pa zambak e karafila,
As më thoni, miq të dashur,
Ku gjen dot të tillë «bandilla»?

Se nuk ishin veç të hurit
e as vetëm të litarit
Po, për fat e për çudi,
Dhe të «penës» e të «zjarrit»!



E si njëri edhe tjetri
Sa i xhepit aqë i gojës.
Le pastaj për punë kulete.
Pararojë e pararojës!

Po ç't'i bësh revolucionit,
Që nuk paska drejtësi,
Që nuk pyetka as për mbretër,
Le pastaj për parësi!

E midis këtij pikllimi,
Veç Zogolli u gëzoka,
Pas kaq vjetësh miqtë e vjetër
Dhe një herë do t'i takoka!

Se dikur të gjithë bashkë
Kanë qenë mehmur Turqie,
E më vonë me Franc Jozefin,
Kush zabit e kush afie!

E kështu, sipas sirasë,
Prapë me Duçen e Hitlerë,
Duke mbetur pors motit
«Patriot» e myteberë!

Ndaj sa mbrrijnë, nga lezeti
Dhe nga malli që i djeg xhanë,
Fort me gaz na çohet mbreti,
Na pret Lumo «demokranë».

Pastaj puth Ali Xhonglerin,¹⁾
Hasan Dostin e Mehdinë,
Abaz Kupin, Baz Ermenin
Dhe Mustaf Këmishëzinë!

... Bukëvale muhabeti.
Vihen pikat përmbi «i»,
Rritet gazi, zjen legata:
— Rrofsh e qofsh, Ameriqi!

1) Ali Këlcyra, një nga krerët e organizatës tradhëtare «Balli Kombëtar». Vegël e okupatorëve fashistë italo-gjermanë,


TEBDIL HAVA NË AMERIKË

U hap fjala, mori dhenë,
Flutroi Zogji n'Amerikë,
Po përse na vate mbreti;
Për kurbet, a politikë?

Ku ta dish, po, siç tregojnë,
Do të blejë një vilë vere,¹⁾
Në i dalt'në kut kjo punë,
«Si lum neve» atëhere!

Sepse, siç mendoka mbreti,
Që andej «pritet shpëtimi»
E syhapët tek sheh ëndërr,
Fluturoka nga gëzimi...

1) Gjatë procesit gjyqësor, Zenel Shehu deklaroi se, për të maskuar qëllimin e vajtjes së Zogut në Amerikë, u tha se ai po shkonte për të blerë një vilë, që do të shërbente edhe si rezidencë e tij atje.




Dikush pyet: — Ai nga halli
Po kaptoka oqeanë,
Po me vete ç'i do mbreti
Zenel Shehn', Hysen Selmanë?

Ehu, «fjalë e fjalë boshe»
Që s'kan'kripë e s'kan'mbarim!
Tani Tafti, Mak Arthuri
Presin mbretin padurim!

Edhe Zogji laj e lyej,
Tundu, shkundu si çingi,
Gjithnjë lepe, gjithënjë peqe,
Për gjithshka u gjet gati!

«Fort gëzohem që ju njoha,
Qenki burrë e çfarë burri,
Me ju puna është e kryer!»
I thotë mbretit Mak Arthuri.

«Veç ky hall do mbajtur fshehtë,
Se ktu puna nuk bitis...
Bujrum lirat dhe avazi
Nga e para prapë nis!»




LEGATA

Pran'varrezash t'faraonve
Thonë qenka një legatë,¹⁾
Aty ngrysen, aty gdhihen
«Patriot'» e «delegatë»!

Ca të ardhur nga Evropa,
Ca serbes nga Amerika,
Nga betimet e fjalimet
Vlon Egjypti, zjen Afrika!

E ka radhën Met Zogolli;
Për sekrete po u flet:
— Zotërinj, me Mak Arthurin
Gjat'e gjan kam folun vetë!

1) Në atë kohë, kur sundonte mbreti Faruk, Zogu qëndronte në Kajro ku kishte hapur edhe një legatë Atje u kurdis edhe komploti nën udhëheqjen e spiunazhit amerikan.



Besa mirë ai ju njipte,
T'gjithë u kishte në tefter,
Ai tha se mbar'Shqypnija
Do shlirohet këtë herë!

E parisë me ëndje mbreti
Gjithë gaz i buzëqesh:
— Si fillim, zotrinj, — ju thotë, —
Bujrum, bujrum nga nj'peshqesh.

Nuk e keni jo prej meje,
Amerika jua çon.
Për mundimet gjithsecili
Merr veç aq sa i takon!

Aher'fill na ngrihet Dosti,
Shpejt më këmbë brof Merlika,
Papo zjarr na merr legata:
— Rroftë e qoftë Amerika!

— Rroftë e qoftë, — thotë dhe mbreti, —
Veçse miqtë tani kërkojnë,
Midis nesh ata të gishtit
Në atdhe të gjithë të shkojnë!



Se ksaj here, për nur t' hakut,
Për të kuqtë s'ka derman,
Kundër tyne gjithë Shqypnija
Urdhën pret qi t'ja baj bam!

Vetëm kaq nga ne kërkohet,
Duhet lujtun politika,
Pa për dru mos kini gajle,
U vjen hakut Amerika!

E mandej, zotrinj të ndershëm,
Po nj'ashtu si vetë e dini,
Mbar'Shqypnin', si dikur motit,
Prap në dorë ju do ta kini.

— Besa, po, — thotë Baz i Canit, —
Le ta nisim Zenel Shehnë
E me të Hamit Matjanin,
Të dy bashkë ta tundin dhenë.

— D'akor! — shton Ali Këlcyra,
Dhe Ermeni¹⁾ është d'akor,
E pas tyre, nga pariya,
Zjen legata mu si kor!

Zjen legata prej gëzimit,
Nisen «trimat» për atdhe,
Një avjon prej Amerike
Përshkon qiellin si rrufe!

1) Ermeni — Abaz Ermeni, një nga krerët kryesorë të Ballit, bashkëpunëtor aktiv i hitlerianëve gjatë okupacionit në Shqipëri.

FLET NJU JORKU

Thonë kanë ardhur
Prej Amerikës
Disa levendë
Të politikës.

Po përse vijnë
E kush i pret?
E ku ta dish:
mision sekret!

Veç Amerika
Orë edhe ças
Për këta trima
Folka me gaz.

Gjëmon Nju Jorku:
«U ngrit Gegnija»,
Kërcen nga shtrati
Lartmadhëria.

E tek mban vesh
Mos tundet dheu:
Thot' «fal'të kjo fsha,
Bre Zenel Shehu,

Se me t'vërtet'
Paske qillue,
Azgan me fletë
E trim drangue.

Nji djalë si ti
Ka dasht' Shqypnia,
Hallall të kjo fshin
motrat e mia!»

Ndërkaq Nju Jorku
S'ka të pushuar,
Thotë: «Qytete
janë rrethuar,

Rrethuar janë
Si asnjëherë,

Tiranë e Kuqe
Pritet të bjerë.


Se rrugve t'saj,
Porsi duhi,
Hamit Matjani
Po bën kërdi!

Hamit Matjani,
Me tre taborrë,
Tiranën nesër
E shtje në dorë!↳

Buçet legata,
S'mbahet paria,
Kërcasin gotat,
S'pushon dollia:

— Të rroj' Zeneli,
Halil Branica!¹⁾
E shishet radhë
Kthehen gërmica.

1) Kapiten Halil Branica, oficer i oborrit të Zogut dhe një nga kryesorët e bandës së Zenel Shehut.



— Me fund! — thotë Bazi, —
Për shokët tanë,
Për mikn'e zemrës
Hamit Matjanë!

Ndërkaq Mustafës
I qesh fytyra,
Fjalimin gati
E ka Këlcyra!

Veç Hasan Dosti
Vret mendjen n'erë:
«Në dorë froni
Kujt do t'i bjerë?»

Shpejtohet Zogji:
«Mos t'isha unë,
Për fjalë të nderit,
S' bahej kjo punë!»

Dhe, sa m'i dehur,
Aq mburret mbreti,
Po jashtë legatës¹⁾
Po pyet mileti:

1) Është fjala për legatën e Zogut në Kajro në kohën e mbretit Faruk.

«Përse gumzhitin
Si valë lumi,
E përse sonte
S'i marrka gjumi?»

Po kot pyet hallku
E kohën humb,
Ku ka si gazi
Kur bëhesh thumb?

Dhe sa për trimat
Aq fort të çmuar,
Që keq Tiranën
«E kan'rrethuar»,

Këtu i kemi
«Shëndosh'e mirë»,
Kurban peshqesh
Nga «Bota e lirë!»

Sepse, siç thonë,
S'ka vlerë liria,
Ku s'çon ksi malli
Ameriqia.

Veç tash për pritje
E për nderime,
Për «brohoritje»
E për fjalime,

Si dhe për çmime
E dekorata,
Fjalën e ka
«Kino Brigada».1)

1) Në sallën e ish kinemasë «Brigada» u zhvillua në prill 1955 proçesi gjyqësor i kësaj bande diversantësh, me Zenel Shehun e Hamit Matjanin në krye.


PJESA E DYTË

KINO BRIGADA

Një zile bie,
Zhurma pushon,
Del Zenel Shehu
Në mikrofon!

E tek sheh armët
Që vetë i solli,
Të gjallë i shfaqen
Xhoni, Zogolli...

Por shpejt gjyqtari
I thurret bandillit:



«Fillo, Zenel,
Për hir të prillit!»

Sepse ky prilli
Qoftë i bekuar,
Me ty hesapet
Fort i ka shtruar!

Dhe ja, ngadalë
«Trimi» fillon,
Zogu prej Kajros
Shtang e dëgjon,

E Mak Arthuri
Nga Vashingtoni,
Që nga Athina,
Kolonel Xhoni,

1) Në prill 1939, Zenel Shehu u largua nga Shqipëria, në prill 1952 u kthye si diversant, në prill të po atij viti u kap. Në prill 1955 u gjykua dhe po në atë prill dha llogari para gjyqit të popullit. Për këto arsye, në këtë vjershërim lozet me fjalën prill.

Veç nga marrazi
Kërcitkan dhëmbët,
Shtrëngokan grushtat,
Përpjekan këmbët...

Porse Zeneli,
Sado i truar,
Këngës së nisur
Ja mbajtka shtruar.

Tregon i gjori:
«Me moretin Zog,
Evropë, Afrikë
I brodhëm tok!

E n'Amerikë
Me të kur shkuam,
Në FBI
Të dy firmuam,

Se, si të thuash,
More të shkretën,
A mund ta lija
Un'mbretin vetëm?


Dhe me Halilin,
N'Athinë kur zbritëm,
Nga Xhoni vetë!¹⁾
Me gaz u pritëm,

E tha: — «Kjo ardhje
është një fitore,
Ksaj her' Shqipria
S'më del prej dore!

Pa do çuditi
Me të arritur,
Rreth jush me mijra
Kan'për t'u ngritur...

Atëher'ju shenjën,
E ne gati,
Tiranë e Kuqe
Do bëhet hi!» —

1) Kolonel amerikan, agjent i FBI-së, i cili organizoi e drejtoi grupin e diversantëve të kryesuar nga Zenel Shehu e Hamit Matjani.



*

* *

Në sallë heshtje;
Mbaroi Zeneli,
Po pas Zenelit
Kush vallë ngeli?

— Halil Branica! —
Thërret gjyqtari,
Po pse i mjeri,
Si gur prej varri,

Del e qëndron
I prishur boje
E dot dy fjalë
S'i nxirrka goje?

Në fund i prerë
Një zë kumbon:
— Të dal' Hamiti
Në mikrofon! —

Thonë dikur
Ish gjel Matjani,
Po sot pse nxin
Si lëng shafrani?

Apo pse klima
Këtu, për dreq,
Për ta ndryshoi
Si mos më keq.

E më s'u shkoka
Zenel Lamashve
Hamit Matjanve,
Ahmet Kabashve?

Por, miq, Lamash
Nuk është Hamiti,
Dikur me vepra
Botën çuditi...

Pra, dhe në hyri
Në radht' e Ballit,
Aspak prej qejfit,
Po veç prej hallit.

Epo kështu,
Milic fashist,
O feldxhendarm,
Eses nazist,

Apo pas lufte
Prap vegël e t'hujve,
Rrogtar a qojle
I shtatë flamujvel

Veç ju do thoni:
Si erdh zamani,
Shpresë e Uollstritit
Hamit Matjani?!

Po ç't'i bësh hallit?
Kohët ndryshuan,
Dreqi e i biri
Keq u ngatrruan!

Pa, rrëfen i gjori
Se si nga zori
Dhe atë vala
Pa dasht'e mori.

E në atë duf
Nis e ankohet:
«Sot puna ime
Hiç s'po shikohet!»

Dhe ka të drejtë,
Sepse gjykata,
Këtij «heroi»
Plot dekorata

Hesap pas vitesh
Po i kërkoka,
Në sy të gjitha
Ja numuroka:

Se si një grua,
O një fëmi,
Se si një bujk,
O një bari,

Vite më parë
I paska vrarë,
Njërin në vatër,
Tjetrin në arë!

Pa i kujtokan
Njerëz e vendel
Po ku, i gjori,
T'i mbajë në mendje?

Sos janë dy,
O pesë, o dhjetë,
Porse të paktën
Dyzina vetë,

E më të shumtit
Vrarë në terr:
Kë për një pulë,
Kë për një berr!

Ja, për ksi punësh
Që nuk mbarokan,
Sot llogari
Po i kërkokan!

Po tek e fundit
Ku është liria?
Atëher'ku mbeti
Demokracia?

Për punë të tilla
Në Amerikë,
Për nder s'të pyesin.
As dhe një çikë!

Porse kjo lidhet
Dhe me njerinë;
Shembull: i bardhi
E vret të zinë...

Pa le kur vrasjen
E bën një zot;
E sidomos
Një «patriot»,

Atëhere vrasjes
I vënë kapak
E më në gojë
S'e zenë aspak!

Dhe ja, në sajë
Të ksaj lirie,
«N'at'bot' të zgjedhur
Demokracie»,

Tregon Hamiti
Se si shpeshherë,
Gazetat dimrin
E quajn'verë,

E verën dimër
E kijamet,
Hidhësin lule,
Ferrin xhenet!

Kështu në Athinë,
Një ditë me vapë,
Kur lum Hamiti
Na ish bërë tapë,

Një shits'gazete
Hyn në mejhanet,
Ngjirur nga zëri
Reklamon lajmet:

«Në Shqipëri
Ndryshoi zamani,
Tani më s'mbahet
Hamit Matjani,

Hamit Matjani,
Me shumë taborrë,
Tiranën nesër
E shtje në dorë!»

Dëgjoi Hamiti
E i erdh gaz,
Po çakërcejfi
Ju prish në ças,

Sepse garsoni,
Një djal'i ri,
Q'e njihte mirë
Kush ish ai,

Gjithë i habitur,
Si mbajti vesh,
I nxori gjuhën
E ju ngërdhesh.

Atëher' prej dufit
Edhe prej hallit
Ju ngrit Matjanit
Damar i ballit;

Dhe atij çunit,
Që e përqeshi,
Me grusht fytyrës
Rrufe ja ngjeshi.¹⁾

1) Pohim i Hamitit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.



... Tani të shkuarën
Me aq lezete,
Mvrenjtur si reja
Mendon me vete;

Pa ju kujtoka
Kolonel Xhoni,
Udhtimi i fundit:
Ekspres avioni!

Dhe ashtu tek endet
Nën qiellin' e butë,
Sërish sheh veten
Në parashutë,

Sikur rrëmbimthi
Diku po zbret,
E posht' Zenelin
Që po e pret!

... Gëzon, por, ah,
Për fat «të zi»
Nuk gjen Zenelin
Me gjith'hordhi,

Po Sigurimin
Me malësorë,
Që, pa rën'mirë,
E shtjen' në dorë!

Dhe ja, prej tmerrit
E prej llahtarit,
Ç'i dalka «gjumi»
Hamit qyqarit!

Gjumi ç'i dalka
E veten mbledhka,
Shpejt nga gjyqtarët
Një sy e hedhka;

Po ç'të shikojë!
Tash dhe gjykata
Po dhënka çmime
E dekorata:

«Hamit Matjanit,
Si kordhëtar,
Përveç trekëmbshit,
Tri pashë litar!

Sa për të tjerët,
Në shenjë «nderimi»
Si dhe nga «malli»
E nga gëzimi,

Meqë s'na ndodhen
Medalje ari,
Gjithkujt nga një
Batare zjarri!»

Po miqtë matanë,
Që nuk e presin,
Nga lajm i hidhur
Gojëhapt' do mbesin...

Ndaj si n'Athinë
Dhe n'Amerikë,
Lusim t'ua thoni
Me takt një çikël!

Se kemi hall,
Mos prej dëshprimit,
U bje të fikët
Xhonit e Xhimit!

LETËR XHONIT

I nderti Xhon,
Jo nga marazi,
Porse nga qejfi
Edhe nga gazi,

Vendosa letër
të të dërgoj;
Se kjo betejë,
Që sot mbaroi,

Është fitore
Që s'ka të çmuar,
Sa ne të gjithve
Na ka gëzuar.

Tani lejomë
Të shpreh urimet,
Mallin e zemrës
E përgëzimet,

Se nuk ka penë
Që ta tregojë,
Shqipri e tërë
Të mban në gojë!

Për ty Zeneli,
Pa le Hamiti,
Me fjalë të «zjarrta»
Botën çuditi!

Njëri thosh «trim»,
Tjetri «bujar»,
Veç, si për sherr,
Një dreq gomar,

Duke ja marrë
Me miqtë tok,
Veten me ty
E hoqi shok...

Nga dufi desha
T'ja pres lirinë,
Po, kur mendova
«Demokracinë».

Thashë: veshgjati,
Mos vallë i ngrati
Është s'andejmi,
Soj Demokrati?!)

Tani, lum Xhoni,
Edhe një fjalë,
Po kujdes fjala
Të mos na dalë.

Pra, që të vihet
Në udhë braza,
Nuk janë tri,
Po katër faza,

1) Partia Demokrate në SHBA ka si emblemë kokën e gomarit. Xhoni ishte anëtar'i kësaj partie.

Dhe gjithsecila,
More bandill,
Ashtu si nis,
Mbaron në prill.

Sepse në prill,
Si gjithnjë tok,
Na shkoi Zeneli
Me mbretin «Zog»

E prapë ish prill
Kur Zenel Shehu,
Si zog qabeje,
Atdheut i ktheu.

Po ti, lum miku,
Përse nxitohesh?
Po të vraç mendjen,
Do të kujtohesh

Se prapë në prill,
Prej mikrofonit,
I foli botës
Dhe Vashingtonit.

Kjo qe e treta
Dhe fort me vend,
Kurse të katrën,
Për hatrin tënd,

Si dhe për vlerat
Që parashtruam,
Dhe ne në prill
E dekoruan!

Andaj, lum Xhoni,
Siç zunë fill,
Të katër fazat
Sosën në prill.


PJESA E TRETË

NA IKU PRILLI NA ERDHI MAJI

Kështu, o miq,
Na iku prilli
E më s'u ndje
Zenel Bandilli!

Po fill pas prillit,
Kollaj-kollaj,
Me tjera derte
Na erdhi maj.

Na erdhi maji,
Oh! Luleshumi,
Po Allen Dallesin
S'e marrkësh gjumi!



Andaj nga halli
Allen i zi
Hartoi me ngutje
Një plan të ri,

Një plan të ri,
Ku s'kish gjë tjetër,
Veçse dhe Sandrin,¹⁾
Si mik të vjetër,

E futi hapët
Në kto «sekrete»,
Që hera-herës
Zgjasin me vjete.

Dhe ja: rrufe
Për në Greqi,
Mister Stefanin
Na çon ai,

Po dhe një tjetër
Për Topçider
Ndër myteberët
Më myteber,

1) Sandrin = Aleksandër Rankoviçin.

Që bukur gurët
Dij t'i lëvizte,
Sa dhe nga pleshti
Dhjam'mund të qiste.

* * *

Ka festë Asfalia,
N'pallat gosti;
He ç'mik, Athinë,
Sot pritke ti!

Rankoviç e Zervë,
Nga malli shpuzë,
Përmallshëm puthen
Buzë për buzë!

Pa nis biseda:
Shkruaj-vulos,
Në pije detet
Ç'u bëkan kos!

E n'atë sulm
T'Megal-idhes,
Vërshon monarkua
Me lug'në brez:



— Ksaj her', ta dini,
Jugu shqiptar,
O bëhet yni,
O flakë e zjarr!

«Dakord, — thotë miku, —
Veç, ah, ky mllef
Ka vjete, qirie,¹⁾
Që m'bën telef.

E shpesh dhe gjumi
I qet' s'më zë,
Shqipnin të vogël
S'e shoh dot më...»

I çelur tjetri
Shpejt gotën rrok:
«Ç'nuk bëm'të ndarë,
Ta bëjmë tok!

Se dhe Hrushovi
I ndjerë fort
Me Venizelon
Kan'rën'dakord,

1) qirie — zotni.

Këtej e tutje
Jugu shqiptar
Një tjetër emër
Në hart'të marrë».

Gazmor udbashi
Potirin çon:
«Për miqësinë,
Fitoren tonë!

Pra, besën, qirie,
Në mes kufinë.
Ju merrni Jugun
E ne Verinë».

* * *

Diku, n'Pire,
Larg prej qytetit,
Udbë e Asfalje
Mblidhen buzëdetit.

E tok me to
Një amerikan,
Një farë zabiti:
Mister Stefan,

Dhe s'ke ç'u thua:
Në pun' të tilla,
Ata të gjithë
Bëjn' «mrekullira!»

Se edhe miqtë
S'i kan'të pakët:
Haki Rushitët,
Panajot Plakët...

E Teme Sejkot
Me gjithë të tjerë,
Kush m'i dëgjuar,
Kush më i ndjerë!

Kështu, të mbledhur
N'at cak mejdani,
Asfalja, Udba,
Mister Stefani,

E me ta bashkë
Jotkë banditi,¹⁾
Spiun i regjur
Haki Rushiti,

1) Panajot Plaku.

Ditë dhe orë
Njësh i vendoskan,
Kur RPSH-në
Do ta fundoskan (?!)

* * *


... Po afron dita,
Po afron ora,
Kur Teme Sejkua
Do t'ja bëj fora!

E nga kufiri
Që s'ka të sosur,
Taborr i huaj,
I armatosur,

Rrufe do derdhet
An'edhe kend,
Pa flakë do ndizet
I gjith'ky vend!

Dhe flotë e gjashtë¹⁾
Aher'kollaj

1) Flota e gjashtë ushtarake e SHBA.



Ka për ta shfryrë
Dufin e saj!

Kështu plot gaz
E ëndërrime
Humb Rankoviçi
Nëpër kujtime.

E si ai,
Kolegu grek,
Dhe lum Stefani,
Që veç një shteg

Kërkoi ç'prej vitesh
E s'e gjet dot,
Po ja ku dita
I erdhi sot!

Veç, ah, për sherr,
Kur pritej ora
Që Teme Sejkua
T'ja bënte fora,

Tamam ahëre,
Pa ja bër çak,
Si shqarthe «fatkeqi»
U kap në lak...

Shkoi dëm gëzimi
I «miqve» t'mjerë,
Udbë e Asfalie
Pikojnë vrer...

Dhe ser Stefani,
Mbetur në hall,
Vajton përpjekjet...
Që i van' në djall.

Po, n'djall përpjekjet,
Me Temen tok,
Veç halli është
Se kët'herë bllok

Na dolën sheshit
N'një shteg të tria:
Asfalja, Udha
E FBI-ja.

E me to bashkë
Brenda në rrjetë
Dhe klloun Hrushovi
Me rrethn'e vetë...

PJESA E KATËRT

Krem'lini nxin,
Mbi Moskë terr,
Në dor' tradhtia
Timonin merr.

E nëpër natë
Pusira ngre,
Ortek bllokada
Derdhet mbi ne.

— Mbaroi Tirana, —
Shkon larg haberi.
Kremtojn' Uollstriti
E Topçideri,

E miqtë e vjetër
Të Derdimenos:
Të qirie Zervës
E vinqeremos.

Pa nis dollia
E fort mërr hov
Për «komunistin»
Gospod Hrushov!

Po mbi tradhtinë,
Bllokadën-gur.
Lart PPSH-ja
Ngrihet flamur.

E s'pyet ajo:
Rreth saj polemi;¹⁾
Sa m'lart furtuna,
Më lart sgalemi.

Tërbohet dallga,
Bregu gjëmon,
Po barrikada
Radhët shtrëngon,

E gjoksin hapur
N'atë rrëmet,
Si bllok betoni
Tallazet pret.

1) polemi — populli, vegjësia.



Thërmohet vala,
Bllokada bje,
Dhe shkëmbi i shqipes
Betonarmé

Mbi brigjet tona
Gjithmonë mal
Qëndron, e dallgve
Një hap s'u fal!

* * *

Dështuan ëndrrat,
Komplotet rrjesht,
Për carët e rinj
E zymt'kjo vjeshtë!

Ankohen miqtë:
— Ç'është'kjo stuhi?
Kaq shpejt nga erdhi
Ky dimër i zi?

Po prap ngushllohen
Tek shohin qark,

Xhonët e Shelbët
Kokëulur varg...

E Rankoviçët.
Zervët e mjerë,
«Q'ky vend i egër»
Bojn'u ka nxjerrë!

Po ç't'i bësh fatit
Kaq zemërgur,
Kur plan e ëndrra
T'i bëka pluhur?

Tani si mumjet
Në galeri
Toptan janë mbledhur
Carë e janki!

Kështu, o miq,
Q'ju pata fjalën,
Ndaj nesh komplotet
Jo, kurrë s'i ndalën;

E prapë syresh
S'kan' hequr dorë,

Po ku pyet mali
Se bie borë?

E ku pyet deti
Se ka piratë?
Gjemi e tyre
Për të: kafshatë.

... Ndaj, për dështimet.
Me nj'torb'tagjie
Sot ngushëllimet
Po rend t'ju shpie

E «gjithë brengë»
Dorën t'ju shtrij:
«Kujdes mbi supe
Kokën, zotrinj!»